



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.05.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)  
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 6 maj 2020 fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami e cila prezanton 3 pikat e rendit të ditës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues të projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afatit për kandidimin në pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile) më datë 29.04.2020, rezulton se kanë kandiduar 11 kandidatë, ku 5 prej tyre kanë kandiduar për të dy pozicionet e lira dhe për të pestë këta kandidatë do të duhet të realizohet një procedurë e vetme verifikimi të kriterëve ligjore të kandidimit për në Gjykatën e Lartë (referuar Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor). Gjithashtu, po referuar këtij akti nënligjor Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet 82 dhe 85, datë 26.02.2020, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Gjithashtu zoti Toska parashtron edhe lidhur me strukturën e projektvendimit, i cili përbëhet nga dy pika. Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet 82 dhe 85, datë 26.02.2020. Ndërsa pika II e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 11 kandidatët për të 2 pozicionet e lira.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, sa i përket procedurave të shortit, propozon që zoti Toska të marrë 3 kandidatë, zoti Toro të marrë 4 kandidatë dhe zonja Shehu të marrë 4 kandidatë.

Hidhet në votim propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për sa i përket procedurave të shortit, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Më pas zhvillohet procedura e caktimit të relatorëve për secilin kandidat duke u futur në një vazo të tejdukshme shiritat e letrës me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në një vazo tjetër shiritat e letrës me emrat e 11 kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë, sipas propozimit të Komisionit, ku shpërndarja e punës nëpërmjet anëtarëve të Komisionit do të jetë e tillë: 3 kandidatë kryetari i Komisionit, zoti Ilir Toska, 4 kandidatë anëtar i Komisionit, zoti Alban Toro dhe 4 kandidatë anëtarja e Komisionit, zonja Marçela Shehu. Procedura e futjes së emrave në vazot respektive kryhet duke u shfaqur çdo shirit me emrin e kandidatit dhe relatorit në kamera.

Procedura e hedhjes së shortit do të jetë e tillë ku fillimisht do të tërhiqet emri i anëtarit dhe më pas emrat e kandidatëve përkatës për atë relator. Pas procedurës së shortit, rezultatet janë si më poshtë sipas radhës:

Anëtarja zonja Marçela Shehu do të jetë relatore për: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Anëtar i zoti Ilir Toska do të jetë relator për: z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Anëtar i zoti Alban Toro do të jetë relator për: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Më pas zonja Naureda Llagami lexon projektvendimin e ardhur nga Komisioni bashkë me relatorët e sapocaktuar në shortin e realizuar pak çaste më parë.

I. Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimi i relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.
2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.
3. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska.
4. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu.
5. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu.
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.
7. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu.
8. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska.
9. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.
10. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska.
11. Për kandidatin z. {...}, relator znj. Marçela Shehu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hidhet në votim projekt-akti i parashtruar më sipër, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

- Maksim Qoku është dakord.
- Brunilda Kadi është dakord.
- Dritan Hallunaj është dakord.
- Ilir Toska është dakord.
- Alban Toro është dakord.
- Fatmira Luli është dakord.
- Marçela Shehu është dakord.
- Erjon Muharremaj është dakord.
- Brikena Ukperaj është dakord.
- Medi Bici është dakord.
- Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për

kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe caktimin e relatorëve sipas shortit.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.05.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)  
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues të projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afatit për kandidimin në pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 88, datë 26.02.2020 më datë 29.04.2020, rezulton se kanë kandiduar 3 kandidatë.

Referuar Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli,



në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020 do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Gjithashtu zoti Toska parashtron edhe lidhur me strukturën e projektvendimit, i cili përbëhet nga dy pika. Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020. Ndërsa pika II e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 3 kandidatët për atë pozicion të lirë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, sa i përket procedurave të shortit, propozon që zoti Toska të marrë 1 kandidat, zoti Toro të marrë 1 kandidat dhe zonja Shehu të marrë 1 kandidat.

Më pas zhvillohet procedura e caktimit të relatorëve për secilin kandidat duke u futur në një vazo të tejdukshme shiritat e letrës me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në një vazo tjetër shiritat e letrës me emrat e 3 kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas propozimit të Komisionit, ku shpërndarja e punës nëpërmjet anëtarëve të Komisionit do të jetë e tillë: 1 kandidat kryetari i Komisionit, zoti Ilir Toska, 1 kandidat anëtar i Komisionit, zoti Alban Toro dhe 1 kandidat anëtarja e Komisionit, zonja Marçela Shehu. Procedura e futjes së emrave në vazot respektive kryhet duke u shfaqur çdo shirit me emrin e kandidatit dhe relatorit në kamera.

Procedura e hedhjes së shortit do të jetë e tillë ku fillimisht do të tërhiqet emri i anëtarit dhe më pas emri i kandidatit përkatës për atë relator. Pas procedurës së shortit, rezultatet janë si më poshtë sipas radhës:

Anëtari zoti Ilir Toska do të jetë relator për: znj. {...}

Anëtarja zonja Marçela Shehu do të jetë relatore për: znj. {...}.

Anëtari zoti Alban Toro do të jetë relator për: znj. {...}.

Më pas zonja Naureda Llagami lexon projektvendimin e ardhur nga Komisioni bashkë me relatorët e sapocaktuar në shortin e realizuar pak çaste më parë.

I. Fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimi i relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.
2. Për kandidaten znj. {...}, relator znj. Marçela Shehu.
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hidhet në votim projekt-akti i parashtruar më sipër, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin

nr.88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe caktimin e relatorëve sipas shortit.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.05.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)  
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
6. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton shkurtimisht relacionin shpjegues të projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afatit për kandidimin në pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 93, datë 26.02.2020 më datë 29.04.2020, rezulton se ka kandiduar vetëm 1 kandidat.

Referuar Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020 do të duhet të caktojë dhe relatorin për kandidatin e vetëm, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Gjithashtu zoti Toska parashtroi edhe lidhur me strukturën e projektvendimit, i cili përbëhet nga dy pika. Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020. Ndërsa pika II e projektvendimit bën fjalë përcaktimin e relatorit për kandidatin e vetëm për atë pozicion të lirë.

Më pas zhvillohet procedura e caktimit të relatorit për kandidatin e vetëm duke u futur në një vazo të tejdukshme shiritat e letrës me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Procedura e futjes së emrave në vazot respektive kryhet duke u shfaqur çdo shirit me emrin e kandidatit dhe relatorit në kamera.

Pas procedurës së shortit, rezultati është si më poshtë:

Anëtari zoti Ilir Toska do të jetë relator për: z. {...}.

Më pas zonja Naureda Llagami lexon projektvendimin e ardhur nga Komisioni bashkë me relatorin e sapocaktuar në shortin e realizuar pak çaste më parë.

I. Fillim i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimi i relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ilir Toska.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët u dakordësuan për projekt-aktin si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe caktimin e relatorit sipas shortit.

Mbledhja konsiderohet e mbyllur.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**